



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2021:066532  
Datë: 24.01.2024  
Numri i dokumentit: 05231117

**AA.nr.185/2023**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrative**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramiz Kuqi kryetar, Delushe Halimi dhe Hajriz Hoti anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit, Xh... K... nga Prizreni, kundër të paditurës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale –Departamenti i Pensioneve, me bazë juridike anulim i vendimit, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.825/2021 të datës 24.01.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 28.12.2023, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Refuzohet** si e pa bazuar ankesa e të paditurës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Departamenti i Pensioneve, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.825/2021 i datës 24.01.2023, **vërtetohet**.

**A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.825/2021 të datës 24.01.2023, në pikën I të dispozitivit është aprovuar në tërësi kërkesëpapia e paditësit Xh... K..., Prizren, kundër të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, si e bazuar. Në pikën II të dispozitivit është anuluar vendimi i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale i datës 30.07.2020 dhe 29.10.2020. Në pikën III të dispozitivit paditësit i njihet e drejta në pension kontribut pagues të moshës nga data 29.04.2020 dhe në vazhdim, detyrohet e paditura Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale që paditësit Xh... K..., Prizren në mënyre retroaktive si pasoj e ekzekutimit të vendimit të kundërligjshëm t'i kompensoj paditësit shumën e kërkuar të precizuar në shumë të përgjithshme prej 2,663.89 euro (dy mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tri euro dhe tetëdhjetë e nëntë cent), e cila shumë përfshinë edhe kamatën ligjore prej 8 % në vit nga data e parashtrimit të padisë 12.04.2021, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë, kurse nga data 25.01.2023 pagesa e pensionit kontributpagues të moshës bëhet

në baza mujore sipas shumës që është e përcaktuar për këtë lloj pensioni. Në pikën IV të dispozitivit të aktgjykimit është vendosur që ky aktgjykim zëvendëson aktet e anuluar dhe ka karakter të detyrueshëm.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka parashtruar ankesë përfaqësuesja e autorizuar e të paditurës, Ministria e Drejtësisë - Avokatura Shtetërore, për shkak të: shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës administrative, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa e të paditurës ashtu që mbetet në fuqi vendimi i shkallës së dytë i dt.29.10.2020 i të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Departamenti i Pensioneve në Prishtinë.

Gjykata e Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore në ankesë, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, gjeti se:

### **Ankesa është e pa bazuar.**

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Departamenti i Pensioneve në Prishtinë, me vendimin me numër të dosjes 343708 të datës 29.10.2020, e ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e z. Xh... K... me nr të ID-së ..... për njohjen e të drejtës në pension kontribut pagues të moshës.

Paditësi i pakënaqur me aktvendimin e lartcekur të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Departamenti i Pensioneve në Prishtinë, ka ushtruar padi për konflikt administrativ, me pretendim se i njëjti është i pa drejtë dhe i pa ligjshëm.

Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit të padisë së paditësit të paraqitur kundër aktvendimit të lartcekur të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Departamenti i Pensioneve në Prishtinë, dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e aprovon si të bazuar, duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar. Me arsyetim se gjykata vlerësoi ligjshmërinë e aktvendimit të goditur në përputhje me nenin 43.3 të LKA-së dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, ku ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar dhe ka konstatuar se vendimet e atakuar nuk përmbajnë elementet e nenit 47 dhe 48 të Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative dhe si të tilla janë të kundërligjshme. Gjykata e shkallës së parë fillimisht iu referua Ligjit për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, të referuar në vendimin e atakuar, konkretisht nenit 8 të këtij. Pastaj nenit 6 par 3 të Udhëzimit Administrativ nr.09/2015 për Kategorizimin e shfrytëzuesve të pensionit kontributpagues sipas strukturës Kualifikuese dhe Kohëzgjatjes së pagesës së kontributeve - stazhit pensional, ku përcaktohet se'' Në rast se në formularin M-4 mungon periudha kontributpaguese deri në 12 muaj përkatësisht një vit dhe në të cilin konstatohet se i siguruari nuk ka bërë ndërrim të organizatës dhe ka mungesë të shënimeve për atë periudhë kontributive në bazë të formularit M-4, të siguruarit mund ti njihet e drejta e periudhës kontributpagues për atë vit''.

Gjykata e shkallës së parë kishte parasysh edhe aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës nën shenjë ARJ-UZVP nr.108/2021 datë 23.09.2021. Gjykata e shkallës së parë për të konstatuar si të kundërligjshëm vendimin e të paditurës kishte parasysh po ashtu edhe aktgjykimin e Gjykatës

Kushtetuese Nr. ref.: AGJ 2113/23 datë 16 janar 2023 2 për faktin se me të njëjtin konstatohet se nenit 8 te Ligjit nr.04/L-131 për Skemat Pensionale te Financuara nga Shteti ne lidhje me nen paragrafin 2.3 te paragrafit 2 te nenit 6 te Udhëzimit Administrativ nr.09/2015 për Kategorizimin e Shfrytëzuesve të Pensionit Kontributpagues sipas Strukturës Kualifikuese dhe Kohëzgjatjes se Pagesës se Kontributeve-Stazhit Pensional, nuk janë ne përputhshmëri me nenin 24 [Barazia para Ligjit] te Kushtetutës në lidhje me nenin 14 (Ndalimi i diskriminimit) të Konventës Evropiane për te Drejtat e Njeriut dhe nenin 1 (Ndalimi i Përgjithshëm i Diskriminimit) te Protokollit nr. 12 te Konventës Evropiane për te Drejtat e Njeriut; kurse e paditura në vendimin kontestues referohet pikërisht në nenin 8 të Ligjit 04/L-131 lidhur me dëshmitë e pamjaftueshme të prezantuara. Nga shkresat e lëndës dhe konkretisht nga vet vendimi i të paditurës konstatohet se këtu paditësi ka 14 vite 6 muaj dhe 17 ditë stazh kontributiv, andaj mbi bazën e provave të administruara si kopje e librit klasës 1998/99,1999/2000, vërtetim datë 21.09.2020,20.05.2020, kopje e faturës data 22.05.2020, vërtetim datë 08.12.2015,18.05.2020, kopje e kartelës data 28.10.1980-kopje e librezës së punës 29.10.1978, vendim dt.01.06.2020, vendim datë 30.07.2020, vërtetim datë 03.06.2020 të ardhurat personale të realizuara (M-4), 24.06.2020, konfirmim datë 26.05.2020, vendim 15.06.2020deklartë datë 23.10.2020 tri deklarata, konstatohet se paditësi i plotëson kërkesat ligjore për të ju njohur e drejta në pension kontributpagues të moshës. Pasi që gjykata e shkalles së parë vërtetoi këto fakte mbi bazën e provave në shkresat e lëndës si dhe në përputhje me dispozitat e ligjeve në fuqi, duke pasur në vëmendje vendimet e listuara të Gjykatave të rregullta dhe Gjykatës Kushtetuese po ashtu, vlerësoi se gjendja faktike ndryshon nga ajo që është vërtetuar në procedurën administrative pranë të paditurës. Duke marr për bazë këtë, gjykata ka vlerësuar se vendimet e të paditurës të shkallës së parë dhe të dytë janë të kundërligjshme dhe si rezultat ka vendosur që paditësit t'i njihet e drejta në Pension Kontribut pagues të Moshës, nga dita kur ka parashtruar kërkesën dhe ka vendosur të njëjtit t'i bëhet kompensimi në emër të kësaj të drejte në mënyrë retroaktive sipas shumës e cila është precizuar në shqyrtim gjyqësor, ku me propozimin e paditësi është caktuar ekspertiza financiare me detyrat e përcaktuara sipas kërkesës së paditësit të dorëzuar me parashtrësën e datës 23.06.2022, andaj mbi bazën e ekspertizës së hartuar me detyrat e përcaktuara sipas kërkesës së paditësit edhe është precizuar kërkesa për kompensim në shumën prej 2,663.89 euro.

Lidhur me kompensimin e përcaktuar si në dispozitiv Gjykata e shkalles së parë kishte parasysh po ashtu nenin 26 të Ligjit për Konfliktet Administrative ku përcaktohet:” 2.3. *kthimi i sendeve të marrura dhe kompensimi i dëmit i shkaktuar me ekzekutimin e aktit administrativ të kontestuar.*”, dhe po ashtu nenin 46 të këtij Ligji ku përcaktohet:” 5. *Me aktgjykim, me të cilin anulohet akti i kontestuar administrativ, gjykata do të vendosë edhe për kërkesën e paditësit për kthimin e sendit, respektivisht për kompensimin e dëmit, nëse të dhënat e procedurës japin për këtë gjë bazë të sigurt. Në të kundërtën, gjykata do ta udhëzojë paditësin që kërkesën e vet ta realizojë në procedurën kontestimore*”. Lidhur me kamatën Gjykata kishte parasysh edhe nenin 382 të Ligjit për Marrëdhëniet Detyrimore ku përcaktohet :” 1. *Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. 2. Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë*”. Lartësia e shumës së kompensimit u vendos sipas shumës së kërkuar nga paditësi. Gjykata e shkalles së parë konstaton se në këtë procedurë të konfliktit administrativ si objekt shqyrtimi kishte vendimin me të cilin i është refuzuar këtu paditësit pensioni kontribut pagues i moshës, lidhur me të vendim edhe ka zhvilluar procedurën gjyqësore dhe ka vendosur si në dispozitiv të vendimit. Nga shkresat e lëndës Gjykata e shkalles së parë ka konstatuar vendimin e datës 01.06.2020 me të cilin paditësit i miratohet pensioni bazë dhe po ashtu vendimin e datës 15.06.2022 mbi njohjen e të drejtës në pension të skemës veteran i UÇK. Gjykata e shkalles së parë po ashtu, kishte parasysh Ligjit Nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të Tyre, i cili ka për qëllim përcaktimin e statusit dhe përkrahjen financiare përmes pensioneve dhe beneficioneve të veçanta për kategoritë e dala nga

lufta e UÇK-së, të cilat me sakrificën dhe kontributin e tyre ishin faktorë vendimtarë për lirinë dhe çlirimin e vendit e në bazë të cilit paditësit i ishte njohur e drejta në pension Invalid Civil i Luftës. Neni 23 i cili ka të bëjë me zbatimin e këtij ligji, në par. 2, përcakton se: *“Shfrytëzuesit e pensionit bazë, mund të realizojnë të gjitha të drejtat dhe beneficinet e përcaktuara me këtë ligj, nëse i përmbushin kushtet dhe kriteret sipas dispozitave të këtij ligji”*. Andaj mbi bazën e të lartcekurave e paditura gjatë zbatimit të pikës III të aktgjykimit lidhur me vazhdimin e njohjes të të drejtës në pension kontribut pagues të moshës dhe pagesën në baza mujore duhet ta ketë në vëmendje nenin 23 të ligjit të sipërcituar, përderisa e drejta në pension kontribut pagues i moshës është e drejt vetanake për të cilin paditësi ka kontribuar përgjatë kryerjes së punës se tij. Gjykata i vë në vëmendje të paditurës po ashtu aktgjykimin e Gjykatës së Apelit AA.nr.34/2022.

Për të vendosur në këtë mënyrë, lidhur me të Drejtën në Pension Kontribut pagues, gjykata e shkallës së parë konsideron se ky lloj pensioni është e drejtë themelore e njeriut dhe se nuk mund të ndahet nga pensioni bazë. Për më tepër, në bazë të praktikës së GJEDNJ ushtrimi i të drejtës në pensionin kontribut pagues të moshës, paraqet ushtrim të së drejtës në pronë, në bazë të nenit 1, Protokollit Nr.1 të KEDNJ i cili në paragrafin 1, përcakton se: *“Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare”*. Lidhur me këtë, në praktikën e GJEDNJ-së ekziston rasti *Gaygusuz v Austria*, i cili ka bërë lidhjen në mes të kontributeve dhe pensionit, ku ka konstatuar se paditësit Z. C... G..., nuk mund t'i mohohet e drejta në pensionin kontribut dhënës, pasi që i njëjti ka paguar kontribute pensionale. Po ashtu, të njëjtin version lidhur me kontributet pensionale, GJEDNJ e paraqet edhe në rastet *Van Raalte v the Netherlands* të datës 21.02.1997 dhe *Bergervoet v the Netherlands* të datës 04.09.2002.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë, duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 43 par.3 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të pretendimeve në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës, me të drejtë i'u ka referuar nenit 8 par. 1 dhe 2 të Ligjit Nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti. Sepse me paragrafin 1 përcaktohet se: *“Kushtet dhe kriteret për njohjen e të drejtës në pension kontributpagues të moshës 1. Të drejtën në pension kontributpagues të moshës e realizojnë të gjithë personat të cilët kanë shtetësi të Kosovës dhe të cilët: 1.1. kanë mbushur moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeçare; 1.2. duhet të ketë stazh pensional kontributdhënës, sipas Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr. 011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK nr.26/83) para datës 01.01.1999; 1.3. ofrojnë dëshmi të vlefshme mbi pagesën e kontributeve sipas dispozitave të Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr.011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK nr.26/83) para datës 01.01.1999. 2. Kategorizimi i shfrytëzuesve të pensionit kontributdhënës, sipas kohëzgjatjes së pagesës së kontributit sipas strukturës kualifikuese dhe kriterëve tjera, përcaktohet me akt nënligjor, të cilin do ta miratoj ministria përkatëse.”*. Ndërsa me nenin 17 të Ligjit Nr.03/L-202 për Konfliktin Administrativ, përcaktohet se *“Në procedurën e konfliktit administrativ mund të kërkohet edhe kthimi i sendeve të marra, si dhe kompensimi i dëmit që i është shkaktuar paditësit me ekzekutimin e aktit që kontestohet.”*

Sa i përket pretendimeve ankimore për shkelje esenciale të dispozitave procedurale, kolegji i kësaj gjykate nuk i aprovoi, meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht i ka dërguar padinë

përfaqësuesit të së paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë, nuk ka bërë shkelje të dispozitave procedurale të LKA-së dhe LPK-së.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, se nuk janë prezantuar dëshmi të mjaftueshme për marrëdhënien e punës nga paditësi për ta provuar kriterin ligjor. Ky kriter ligjor nuk është plotësuar nga paditësi për t'ia njohur të drejtën në kompensim si në dispozitiv të aktgjykimit e që paraqet kusht ligjor për realizimin e kësaj të drejtë nga së paditësi ka vetëm 14 vite, 6 muaj dhe 17 ditë stazh kontributiv. Në këtë drejtim gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale. Këto pretendime ankimore, kolegji i kësaj gjykate nuk i aprovoi ngase vlerëson se janë të pa bazuara dhe të pa qëndrueshme, për faktin se gjykata e shkallës së parë me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit, ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e të paditurës janë të pa bazuara dhe të pa qëndrueshme, ngase të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, dhe në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës, meqë aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Kolegji i kësaj gjykate ka shqyrtuar edhe pretendimet tjera ankimore të paditurës, se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale dhe nëse do të kishte evituar shkeljet e lartcekura atëherë do të mund të aplikonte edhe të drejtën materiale, sepse për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nuk mund të bëhet zbatimi i drejtë i të drejtës materiale. Mirëpo këto pretendime nuk i aprovoi, ngase të njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa argumentuara me prova konkrete të cilat do të gjenin mbështetje ligjore, dhe si të tilla janë pa ndikim në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Andaj, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale me rastin e aprovimit si pjesërisht të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**AA.nr.185/2023, me datë 28.12.2023**

**Kryetari i kolegjit,**  
Ramiz Kuqi